



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1700, datë 20.10.2011**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1652, datë 18.07.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.10.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1652, datë 18.07.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k., dhe Eagle Mobile sh.a., të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1652, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”;
2. *Shkresa e AKEP me nr. 308/1, datë 18.07.2011 “Mbi çështjen e moslidhjes së marrëveshjes se interkoneksionit me sipërmarrësin ABCom sh.p.k.”.*
3. Shkresa e AKEP nr. 1211 prot, datë 19.07.2011 “Njoftim Vendimi nr. 1652, datë 18.07.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP”;
4. Shkresa nr. 1206 prot, datë 19.07.2011 e AKEP drejtuar sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a. “Njoftim për seancë dëgjimore në selinë e AKEP”;
5. Shkresa e Eagle Mobile sh.a. me nr. 3615Prot., datë 2.10.2011, (nr. 1614 Prot. i AKEP, datë 12.10.2011) me të cilën depoziton “Marrëveshjen e interkoneksionit lidhur ndërmjet Eagle Mobile sh.a. dhe ABCom sh.p.k.”;
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R Ë N:

1. AKEP me anë të Vendimit nr. 1652, date 18.07.2011 të Këshillit Drejtues “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

*“Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”;*

*Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a për fillimin e procedimit administrativ;*

*Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit”;*

2. AKEP me anë të shkresës nr. 301/8, së datë 18.07.2011, i është drejtuar Eagle Mobile dhe për dijeni ABCom sh.p.k. në lidhje me çështjen e moslidhjes së marrëveshjes së interkoneksionit me sipërmarrësin ABCom sh.p.k. Gjithashtu, duke i sjellë në vëmendje sipërmarrësit Eagle Mobile se në mënyrë të vazhdueshme ka refuzuar fillimin e negociatave për lidhjen e MI-se duke e justifikuar me arsye që lidhen me nxjerrjen e akteve nga ana e AKEP, në përgjigje të ankimeve që Eagle Mobile ka paraqitur, lidhur me miratimin e RIO-s, dhe me pas me shqyrtimin e ankimeve administrative të Eagle për çështje që lidhen me RIO-n.  
Meqënëse pretendimet e sipërmarrësit FNT Eagle Mobile, kundrejt kërkesës për interkoneksion të ABCom sh.p.k për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit lidhen me çështje për të cilat AKEP tashmë është shprehur me vendimet përkatëse të KD-së, për rrjedhojë konsiderohet se nuk ka më arsye të drejta të cilat të bëhen pengesë për lidhjen e MI-së, për këtë arsye me VKD nr. 1652, datë 18.07.2011, Këshilli Drejtues ka vendosur fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.
3. Për sa më sipër, në vijim të këtij fillim procedimi administrativ me anë të shkresës nr. 1206 prot, datë 19.07.2011, “Njoftim për seancë dëgjimore në selinë e AKEP”, AKEP ka çmuar të thërrasë në një seancë dëgjimore sipërmarrësit ABCom dhe Eagle Mobile në selinë e AKEP më datë 21.07.2011 ora 12: 00;
4. Gjatë seancës dëgjimore, të mbajtur në selinë e AKEP morën pjesë përfaqësuesit e sipërmarrësit ABCom sh.p.k, Eagle Mobile sh.a dhe përfaqësues nga AKEP, vërehet se:
  - ABCom konfirmoi se janë të predispozuar në çdo moment për të arritur një marrëveshje me Eagle Mobile. Kërkesa e tyre mbetet e njëjtë, realizimi i drejtpërdrejt i interkoneksionit me operatorin Eagle Mobile, kjo për arsye teknike por edhe biznesi. Gjithashtu, ABCom vlerësoi se janë të gatshëm që nëse u plotësohen kërkesa të tërheqin ankimeve të tyre.
  - Eagle Mobile u shpreh se shumë shpejt do të caktojme një takim me operatorin ABCom për të zgjidhur problematikat që kanë mbetur, si kapacitetet, garancitë për të realizuar cilësinë e shërbimit. Trafiku është i dyanshëm. Gjithashtu, Eagle Mobile vlerësoi se operatori Abcom është një operator korrekt dhe me peshë në treg.
  - ABCom theksoi se edhe mund të tërhiqen nga ankimeve të tyre pas këtij takimi, pasi nuk kanë asnjë interes në hapjen e konflikteve, duke qëndruar korrekt në terma teknik dhe financiar.

- Eagle Mobile shprehu bindjen për të finalizuar me sukses këtë problematikë, dhe premtoi ne AKEP se brenda afatit 15 ditor do të fiksojnë një takim me operatorin ABCom, për dijëni dhe AKEP, për të mbyllur të gjitha pikat e kesaj mosmarrëveshjeje.
5. AKEP, pasi dëgjoi pretendimet e palëve, e vlerësoi të mbyllur këtë seancë dëgjimore duke shpresuar në ftesa për takim dhe negociata tregtare nga ana e tyre, përgjatë kësaj periudhe të shqyrtimit administrative nga ana e AKEP. AKEP kërkoi edhe njëherë vënien në dijëni për çdo veprim apo letërkëmbim që ka lidhje me objektin e mosmarreveshjes dhe me këto palë.

## **7. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:**

**I.** Në lidhje me thelbin e kësaj mosmarrëveshjeje, e pasqyruar si moslidhja e marrëveshjes së interkoneksionit midis palës kërkuese dhe ofruese, detyrimi për akses dhe interkoneksion është një detyrim të cilin AKEP me vendimin nr. 1212, date 31.03.2010, të Keshillit Drejtues, e ka vendosur për sipermarresin Eagle Mobile.

Në asnjë rrethanë, pavarësisht pretendimeve të palëve, nuk duhet të ndodhë që interkoneksioni të mos realizohet ku janë plotësuar kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 9918, për vendosjen nga AKEP të detyrimit për akses dhe interkoneksion.

Në këtë rast, Eagle Mobile si Ofrues i Interkoneksionit dhe si sipërmarrës FNT ka detyrimin ligjor për mosdiskriminimin, transparencën dhe zbatimin e të drejtës për interkoneksion të Operatorit Përfitues ABCom sh.p.k të autorizuar sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm nga AKEP, në përputhje të kërkesat dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

**II.** AKEP, pas deklarimeve të këtyre palëve pjesëmarrëse në procedimin administrativ, dhe në kuadër të bisedimeve gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në selinë e AKEP, më datë 26.09.2011, bëhet me dije nëpërmjet postës elektronike zyrtare nga përfaqësuesit e sipërmarrësit Eagle Mobile drejtuar ABCom sh.p.k, se:

Ka përfunduar testimi i pajisjeve dhe trafikut (Voice & MNP) dhe konfirmohet drafti i marrëveshjes midis ABCom dhe Eagle Mobile duke bërë prezent gadishmerinë e Eagle Mobile për nënshkrimin e saj si duke dhe kërkuar firmosjen e tre kopjeve nga ana e ABCom sh.p.k.

**III.** Sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a, me ndërhyrjen administrative të AKEP, përfundimisht ka rënë dakord të interkonektojë rrjetin e tij me ABCom sh.p.k. në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9918, dhe Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit, dhe t'i sigurojnë njëra-tjetrës shërbimet dhe facilitetet sipas kushteve të parashikuara në dokumentin e RIO-s së Eagle Mobile sh.a.

Eagle Mobile sh.a. me shkresën nr. 3615Prot., datë 2.10.2011, ka depozituar “Marrëveshjen e interkoneksionit lidhur ndërmjet Eagle Mobile sh.a. dhe ABCom sh.p.k.”,

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## **V E N D O S:**

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1652, datë 18.07.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”
2. Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a. për mbylljen e procedimit administrativ;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE